

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA
OFFICE OF PARENT, FAMILY AND COMMUNITY ENGAGEMENT
440 N. BROAD STREET, SUITE 114
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

KARREN N. DUNKLEY
DEPUTY CHIEF

TELEPHONE: (215)-400-4180
FAX: (215)-400-4181

Zyra e Angazhimit të Prindërve, Familjes dhe Komunitetit siguron angazhimin e prindërve dhe mbështet partnerishipin efektiv të familjes, shkollës dhe komunitetit. Duke filluar nga Shtatori i 2009, Drejtorja kërkon një prind vullnetar (dhe një rezervë) **për çdo shkollë që**, të shërbejë në Ekipin- Prindërit janë Partnerë të Barabartë (PREP) të mbarë Distriktit. Duke e vlerësuar diversitetin në shkollat tona, ne inkurajojmë pjesëmarrjen nga grupet etnike sa më të vogla duke përfshirë prindërit që nuk flasin mire Anglisht, burrat, prindër të nxënësve me përparim të dobët, adoleshentë, dhe gjyshër apo kujdestarë. Anëtarësimi në Shoqatën Shkollë-Familje apo ndonjë organizatë tjetër të prindërve **NUK** është kërkesë e domosdoshme.

Përfaqësuesit e PREP-it do të marrin training tremujor dhe informacion rreth kërkesave dhe rregulloreve të ligjit Title I. Tematikat do të përfshijnë, (por nuk do të kufizohen) përgjegjësitë dhe të drejtat e prindërve, vlerësimet e shtetit dhe lokale, diferencat në arritjet akademike, procesi i përmirësimit të shkollës, dhe shërbimet plotësuese arsimore (SES). Ne kërkojmë, që çdo përfaqësues i PREP-t (dhe/ose kandidati reserve) të ofrojë një training të plotë tek prindërit në shkollat e tyre respektive. Përfaqësuesit e PREP-it do të ftohen të përfaqësojnë Drejtorinë në konferencat dhe eventet lokale, rajonale dhe në rang shteti (**me kosto minimale ose pa shpenzime nga ana juaj**).

Prindërit Ombudsmen të një rajoni, Koordinatorët Rajonalë të NCLB, anëtarët e Komitetit Rajonal të Këshillit të Prindërve (PAC), stafi i Drejtorisë në Zyrën e Angazhimit të Prindërit, Familjes dhe Komunitetit, dhe Prindi Ombudsmen i shkollës do të jenë të gatshëm të asistojnë me trainingun në shkollë. Ju lutemi, vendoseni këtë informacion në një vend të dukshëm në zyrën e shkollës. Emrat e të **gjithë** prindërve të interesuar duhen dërguar tek Prindi Ombudsmen i shkollës ose rajonit deri më **19 Qershor**.

Çdo prind i interesuar do të plotësojë aplikimin bashkëngjitur (që mund ta gjeni në shkollën e fëmijës tuaj përmes prindërit ombudsmen të rajonit, ose në Qendren e Informacionit të Prindërve dhe Komunitetit). Aplikimit (të bashkëngjitur) gjithashtu mund t'i faksoni në zyrën tone në numrin e faksit 215-400-4048 ose të sillen dorazi tek kjo qendër me adresën 440 North Broad Street, kati i pare.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj të pritshëm. Ju mund të kontaktoni Quibila A. Divine në numrin 215-400-6443 ose me email qadivine@philasd.org për çdo pyetje që mund të keni.

Quibila A. Divine,
Drejtoreshë, Zyra e Angazhimit të Prindërve dhe Familjes

Drejtoria Arsimore e Filadelfias
Përfaqësia Prindërit Partnerë të Barabartë (PREP)
Aplikim për Vullnetarë

Cfarë është Title I?

Title I është një pjesë nga ligji “Asnjë Fëmijë mos të Mbetet Mbrapa” i miratuar nga Kongresi i SHBA në vitin 2002. Ky ligj përmban kapituj për shkollat fillore dhe të mesme publike në çështje të tilla, si përdorimi i fondeve federale, trainimi i mësuesve, arritja akademike, të drejtat e prindit, udhëzime për atë pjesë të nxënësve me nevoja specifike dhe barazi në veprimtari atletike.

Data _____

JU LUTEMI ME
SHKRONJA SHTYPI

Emri _____

Adresa _____ Zip kod _____ - _____

Tel. i shtëpisë _____ Tel. Cell _____

E-mail _____ Faks _____

Emri/at i/e fëmijës/ve _____ Klasa/t _____ Shkolla/t _____ Rajoni/et _____

Cilin nga grupet demografike përfaqësoni? Shënoni të gjitha ato që ju përkasin:

- | | | |
|---|---|---|
| <input type="checkbox"/> Afrikan | <input type="checkbox"/> Gjyshërit | <input type="checkbox"/> Prind me fëmijë në shk. të mesme |
| <input type="checkbox"/> Afrikan Amerikan | <input type="checkbox"/> Emigrant/Refugjat | <input type="checkbox"/> Pre – K/Parashkollor |
| <input type="checkbox"/> Aziatik | <input type="checkbox"/> Latino | <input type="checkbox"/> Rajoni _____ |
| <input type="checkbox"/> Kujdestar | <input type="checkbox"/> LGBT(Orientim seksual jotradicional) | <input type="checkbox"/> Nevojat speciale _____ |
| <input type="checkbox"/> Nxënës që mësojnë Anglisht | <input type="checkbox"/> Të tjera _____ | <input type="checkbox"/> Prind me fëmijë adoleshentë |

Experienca – Ju lutemi jepni informacion për Organizatat, Grupet, Bordet ku ju keni shërbyer:

Emri i Organizatës, etj.	Experienca në		Emri për kontaktim	Telefon
	5 vjetët e fundit/Para			
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		

E kam të qartë se me plotësimin e këtij formulari, Unë dëshiroj të merrem në konsideratë për përzgjedhjen si vullnetar i përfaqësues të PREP.

Firma _____ Data _____

Ju lutemi ktheni aplikimin e plotësuar në: Quibila A. Divine; 440 N. Broad Street, Room 114; Philadelphia, PA 19130; (Faks) 215-400-4048; e-mail gadivine@philasd.org ose telefononi në 215-400-6443